



VDEKJE E DYSHIMTË NË KOMORAN: NË SHTËPINË E VIKTIMËS GJENDEN ARMË ZJARRI E GRANATA DORE



INSAJDERI

🕒 rreth 8 orë më parë



Një person është gjetur pa shenja jete gjatë mbrëmjes së djeshme në fshatin Komoran të Drenasit, njofton Insajderi.

Siç njofton Policia e Kosovës, viktimja është gjetur në shtëpinë e tij pa shenja jete, ndërsa në objektin përcjellës të shtëpisë së viktimës, janë gjetur dhe janë konfiskuar armë zjarri AK-47, karikatorë dhe dhjetëra fishekë.

Trupi i pajetë i viktimës është dërguar në Institutin e Mjekësisë Ligjore për obduksion.

“Fshati Komoran, Glllogoc 10.11.2020 – 19:43.Raportohet se në shtëpinë e tij është gjetur pa shenja jete viktimja mashkull kosovar. Në objektin përcjellës të shtëpisë së viktimës, janë gjetur dhe janë konfiskuar armë zjarri AK-47, katër karikatorë me nga 30 fishekë, tre detonatorë elektrikë, shtatë granata dore, si dhe një sasi e municionit të ndryshëm. Trupi i pajetë i viktimës është dërguar në IML për obduksion”, thuhet në njoftimin e policisë. */Insajderi.com*

#Komoran


#vdekje e dyshimte




LAJME




KOMISIONI PËR LEGJISLACION INTERVISTON SOT KANDIDATËT PËR ANËTARË TË KËSHILLIT GJYQËSOR




KRYEDIPLMATJA I DREJTOHET VETËVEDOSJES: MOS E QUANI SERBINË REPUBLIKË
🕒 RRETH 10 ORË MË PARË



SOT QEVERIA PREZANTON MASAT E REJA ANTI-COVID, JANË PARALAJMËRUAR ATO EKSTREME
🕒 RRETH 10 ORË MË PARË



VDEKJE E DYSHIMTË: GJENDET PA SHENJA JETE NË BANESËN E TIJ
🕒 RRETH 9 ORË MË PARË



POLICIA VAZHDON TË SHPËRNDAJË GJOBA
🕒 RRETH 9 ORË MË PARË

MË SHUMË NGA RUBRIKA LAJME


NGA RUBRIKAT



TË FUNDIT



TË FUNDIT



NGA RUBRIKAT



HULUMTIME/ANALIZA

